



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 118, datë 11.9.2019

PËR

**MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS
SË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Struktura e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit të jetë, gjithsej, 12 veta.
4. Urdhri nr.142, datë 28.3.2014, i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Realizimit të Veprave të Artit”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ORGANIKA E QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1 DREJTOR	II-b	1
2 SEKTORI I KRIJIMTARISË LETRARE DHE PËRKTHIMIT		4
SPECIALIST	IV-b	1
3 SEKTORI I LEXIMIT DHE BIBLIOTEKAVE		3
SPECIALIST	IV-b	3
4 SEKTORI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		4
SPECIALIST	IV-a	1
PUNONJËS SHËRBIMI		1
NËPUNËS INFORMACIONI		1
PUNONJËS PASTRIMI		1
PUNONJËS GJITHSEJ		12

KRYEMINISTRI

EDI RAMA